UDHËZIM
Nr. 3918, datë 18.7.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË 18.11.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në hyrje të udhëzimit, togfjalëshi "në zbatim të nenit 84, pika 5", zëvendësohet me togfjalëshin "në zbatim të nenit 84, pika 4".

Neni 2

Në nenin 8, pas pikës 3, shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

"3.1. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 3 të këtij neni, licencat për shërbimin e rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve, për linjat e përcaktuara në aneksin 2 të këtij udhëzimi, lëshohen nga bashkitë përkatëse".

Neni 3

Në nenin 14, pas paragrafit të parë të pikës 1, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Transportuesit që kryejnë transport të rregullt udhëtarësh, në linjë me itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara konform licencës së lëshuar për këtë qëllim e ofrojnë këtë shërbim kundrejt "Rregullores së udhëtimit" sipas udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, "Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar".

Neni 4

Pika 2 e nenit 17 riformulohet si më poshtë:

"2. Afati i vlefshmërisë së certifikatave për autobusët e shërbimit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës është nga 1 deri në 5 vjet".

Neni 5

Pika 2 e nenit 20 riformulohet si më poshtë:

"2. Në rastin e shërbimeve të rregullta të specializuara referuar, si dokumente kontrolli në rrugë, të cilat duhet të mbahen në mjet, janë: licenca, certifikata përkatëse e mjetit, si dhe kontrata ndërmjet subjektit dhe organizatorit të transportit dhe lista e udhëtarëve. Udhëtarët duhet të jenë punonjës të ndërmarrjes ose nxënës të institucionit shkollor".

Neni 6

Pika 6 e nenit 23 riformulohet si më poshtë:

"6. Mbajtësi i licencës, pas pagesës së çdo udhëtari që përdor këtë shërbim, është i detyruar të pajisë atë me biletë ose faturë si provë e ekzistencës së një kontrate mes tyre. Mosrespektimi i kësaj dispozite dënohet me masë administrative sipas neneve 10, 68 dhe 71 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar".

Neni 7

Modeli nr. 306 i librit të udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit, të udhëzimit të ministrit nr. 20, datë 10.10.2007, "Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 8

Certifikatat për autobusët e shërbimit qytetës dhe rrethqytetës, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë të vlefshme deri në afatin e vlefshmërisë së tyre të përcaktuar në certifikatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj